



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

NJOFTIM PËR MEDIA

Ditën e martë, në datën 27 prill 2021, në mjediset e AMA-s, u zhvillua mbledhja e radhës së Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

Gentian	SALA	Kryetar
Sami	NEZAJ	Zëvendëskryetar
Gledis	GJIPALI	Anëtar
Suela	MUSTA	Anëtar

AMA pasi shqyrtoi çështjet e rendit të ditës, vendosi:

1. Miratimin e raportit të tabelave përmbledhëse të monitorimit të mbulimit të fushatës zgjedhore nga OSHMA-të për periudhën 26 mars - 23 prill 2021 si dhe respektimin e periudhës së heshtjes zgjedhore. **(Vendimi nr. 62, datë 27.04.2021)**
2. Miratimin e rregullores “Për procedurat dhe kriteret për dhënien e autorizimit për përdorimin e frekuencave të brezit HF, për ofrimin e shërbimit audio”. **(Vendimi nr. 63, datë 27.04.2021)**
3. Miratimin e një shtesë në vendimin e AMA-s, nr. 220, datë 01.12.2017 “Mbi përcaktimin e pagesave për licencë/autorizim dhe shërbimet që kryhen nga Autoriteti i Mediave Audiovizive”. **(Vendimi nr. 64, datë 27.04.2021)**
4. Pranimin e kërkesës së RTSH-së për caktimin e Numrave Logjikë të Programit për shërbimet programore të Radio Televizionit Shqiptar”. **(Vendimi nr. 65, datë 27.04.2021)**
5. Pranimin e kërkesës së shoqërisë “RTV Adria-Med” sh.p.k., dhe kalimin e të drejtave të licencës së shoqërisë “RTV Adria-Med” sh.p.k., për subjektin audio privat “Radio Durrësi” tek shoqëria “Radio On” sh.p.k. **(Vendimi nr. 66, datë 27.04.2021)**
6. Miratimin e ndryshimeve të ndodhura në strukturën e pronësisë së shoqërisë “RrTL-OTT” sh.p.k., autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet IP (OTT) “RRTL-OTT”. **(Vendimi nr. 67, datë 27.04.2021)**
7. Kalimin e të drejtave që burojnë nga licenca e subjektit person fizik Zenel Hoxhaj, për shërbimit e programit audioviziv “Tv Kopliku”, tek shoqëria “Tv Kopliku” sh.p.k. **Vendimi nr. 68, datë 27.04.2021)**

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Tiranë, më 27.04.2021